



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË  
DREJTORIAE PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR  
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DURRËS

Durrës, më 14. 09. 2020  
(Lutemi referojuni në rast përgjigje)

**NJOFTIM  
PËR REGJISTRIMIN E KANDIDATËVE TË PRAKTIKËS PROFESIONALE  
PËR PROFESIONIN E RREGULLUAR TË MËSUESISË**

Drejtorja Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës, mbështetur në shkresën Nr. 4814, datë 11.09.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm të MASR, njofton të gjithë studentët dhe kandidatët që kanë përfunduar studimet universitare në fushën e edukimit (mësuesisë) të aplikojnë për regjistrimin në praktikën profesionale për vitin shkollor 2020-2021.

Kandidatët që do të pranohen në praktikën profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit duhet të kenë përfunduar programin e studimeve të ciklit të parë dhe programin e studimit të ciklit të dytë (Master i shkencave/ Master i Arteve të Bukura/ Master Profesional) në FUSHËN E EDUKIMIT, që përmban lëndët pedagogji dhe psikologji.

Profili ku kandidati do të zhvillojë praktikën profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit lidhet me programin e studimit të ciklit të parë që ka përfunduar kandidati.

Aplikimi do të realizohet nga data **16.09.2020** deri në datën **21.09.2020**. Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet përkatëse pranë Zyrove Arsimore përkatëse tek sektori i monitorimit të kurrikulës dhe zhvillimit profesional.

Dosja për regjistrimin përfundimtar do të ketë:

1. Formularin e aplikimit sipas formatit bashkëngjitur
2. CV e praktikantit; (**e detyruar** të shënohet numri i kontaktit dhe adresa e email-it)
3. Fotokopje e dokumentit të identifikimit; (kartë identiteti ose pasaportë biometrike)
4. Fotokopje e noterizuar e diplomës së studimeve universitare në fushën e edukimit (bachelor dhe master); (**E detyruar**)
5. Fotokopje e noterizuar e listës së notave të lëshuar nga institucioni i arsimit të lartë; (**E detyruar**)
6. Raporti mjeko- ligjor; (**I detyruar**)
7. Vërtetim nga prokuroria që nuk është në ndjekje penale. (**I detyruar**)
8. Vërtetim banimi nga njësia administrative përkatëse.

**Kandidatët që nuk kanë një prej dokumenteve të detyruara të mësipërme do të skualifikohen nga praktika profesionale.**

**Nuk mund të pranohen aplikime me vërtetim, nëse nuk paraqiten diplomat përkatëse sipas përcaktimeve ligjore.**

Tërheqja e formularit do të bëhet pranë zyrës përkatëse.

**Shënim!** Zyrrat Vendore të Arsimit Parauniversitar do të pranojnë aplikime mbështetur në dokumentin e vendbanimit të kandidatit.